

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues Artan Sejrani, me anëtarët Xheladin Osmani e Luan Berisha si anëtar të trupit gjykues, me procesmbajtësen Florije Kolukaj, në lëndën penale kundër të akuzuarve Gj.K dhe K.Z që të dy nga ..., Republika e Shqipërisë dhe A.M nga fshati ... - ..., Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 parag. 2 lidhur me nenin 281 parag. 1 nën parag. 1.9 dhe neni 31 te KP-së, duke vendosur sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.53/2017 të datës 29.05.2017 dhe PP.nr.254/2016 të datës 16.01.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në praninë e Prokurorit të Shtetit Genc Nixha, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av. B.Sh nga ..., av. S.M dhe av. A.B që të dy nga ..., me datën 23.01.2018 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. Gj.K, nga i ati D. dhe e ëma K., e lindur ..., i lindur me dt..., në fshatin ..., me banim në ..., R. e Shqipërisë, i martuar, babë i tre femive, punëtor, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë.

2. K.Z, nga i ati N. dhe e ëma D., e lindur ..., e lindur me dt..., në ..., me banim të përhershëm në ..., R. e Shqipërisë, e martuar nën e dy femive, ka të kryer shkollën e mesme, punëtoare, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Shqipërisë.

3. A.M, nga i ati G., e ëma K., e lindur ..., i lindur me dt..., në ..., me banim në fshatin ..., R. e Shqipërisë, i martuar baba i dy femive, nuk din shkrim lexim, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë.

JANË FAJTORË

Se me datë 22.10.2016, në periudhën kohore prej 05:40 deri me 07:50 minuta, pa autorizim kanë transportuar dhe ndërmjetësuar transportin e dërgesës - substancës psikotrope të llojit marihuan me qëllim të shitjes ose ofrimit për shitje në atë mënyrë që të akuzuarit Gj.K dhe K.Z janë nisur drejtë kufirit Kosovë – Shqipëri për të sjellur dërgesën në Kosovë prej 39 kg e 0,35 gr, substancë psikotropike të llojit marihuan, me ç “rast i akuzuari Gj.K dhe K.Z kanë pritur në territorin e Kosovës në afërsi të vend kalimit kufitar duke komunikuar dhe koordinuar dërgesën e marihuanës me të akuzuarin A.M i cili nga territori i Shqipërisë paraprakisht ka pranuar dërgesën me marihuan nga personi i cili quhet B.. (A.), e pastaj ka kaluar në këmbë në territorin e Kosovës duke shfrytëzuar bregun e liqenit të fshatit Vërmicë, ashtu që bartë në shpinë tri thasë në të cilën janë gjetur 60 paketime të mbështjellura me substancë psikotropike të llojit marihuan dhe një najlon me ngjyrë të

zezë po ashtu të mbushur me substancë psikotropike marihuan me peshë totale prej 39 kg, e 0,35 gr, i cili po sa të vërehet nga ana e zyrtarëve policor të cilët kanë qenë në pikë vëzhgim afër bregut të liqenit i akuzuari A.. largohet me vrap duke i hudhur thasët dhe lajmëron me telefon të akuzuarin Gj.K dhe K.Z se është i rrethuar dhe ndaluar nga policia kufitare.

- Këso dore kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 parag. 2 lidhur me nenin 281 parag. 1 nën parag. 1.9 dhe 31 të KP-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 17, 21, 33, 41, 42, 43, 45, 46, 69, 73, 74, 83, 273 para. 2, 281-1-1.9 të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i :

GJYKON

- Të akuzuarin **Gj.K**, me dënim me burg në kohëzgjatje **prej 4 (katër) vite**, dhe me dënim me **gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) €**, të cilin dënim është i obliguar të paguajë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- Të akuzuarën **K.Z**, me dënim me burg në kohëzgjatje **prej 4 (katër) vite**, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 24.05.2017 deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, si dhe dënimin me **gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) €**, të cilin dënim është i obliguar të paguajë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- Të akuzuarin **A.M**, me dënim me burg në kohëzgjatje **prej 3 (tre) vite**, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.10.2016 deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, si dhe me dënim me **gjobë në shumë prej 500 (pesëqindtë) €**, të cilin dënim është i obliguar të paguajë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- Nëse të akuzuarit nuk mund apo nuk dëshirojnë të paguajnë dënimet me gjobë, të njëjtat do të zëvendësohen me dënime me burg ashtu që çdo 20 € të dënimit me gjobe do të llogaritet një ditë burgu.
- Nga të akuzuarit konfiskohet substanca narkotike në peshë të përgjithshme prej 39 kg, e 0.35 gr.
- Obligohen të akuzuarit, që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë paushallin gjyqësor secili në lartësi me nga 100 (njëqind) euro, të gjitha këto në afat prej 15 dite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzat PP/I.nr.53/2017 të datës 29.05.2017 dhe PP.nr.254/2016 të datës 16.01.2017,

kundër të akuzuarve Gj.K dhe K.Z që të dy nga ..., Republika e Shqipërisë dhe A.M nga fshati ... - ..., Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 parag. 2 lidhur me nenin 281 parag. 1 nën parag. 1.9 dhe neni 31 te KP-së.

Gjykata me vendimin PKR.nr.61/17 të datës 10.10.2017, ka bashkuar procedurën penale për lëndët penale PKR.nr.12/17 dhe PKR.nr.61/17 të cilat zhvillohen kundër të akuzuarve Gj.K dhe K.Z që të dy nga ..., R. e Shqipërisë, për shkak të veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 parag. 2 lidhur me nenin 281 parag. 1 nën parag. 1.9 dhe neni 31 te KP-së dhe të akuzuarit A.M nga fshati ... - ..., R. e Shqipërisë, për shkak të veprës penale, blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 parag. 2 lidhur me nenin 281 parag. 1 nën parag. 1.9 dhe neni 31 te KP-së.

Prokurori i shtetit Mehdi Sefa në fjalën përfundimtare ndër të tjera ka deklaruar se me që kemi të bëjmë në çështjen e njëjtë penale, me të akuzuarit të cilët kanë vepruar në kohë të njëjtë, në vend të njëjtë dhe në rastin e njëjte bashkërisht atëherë që veprimet e të akuzuarve A.M, Gj.K dhe K.Z ti barti në kuadër të një dispozitivi asgjë nuk do të ndryshon nga përshkrimi faktik dhe përshkrimi ligjor dhe cilësinë e veprës penale, por veprimet e këtyre do të bartën në kuadër të një dispozitivi. Kjo gjendje faktike e përshkruar si në dispozitiv është vërtetuar në tërësi gjatë seancave kryesore, nga provat e administruara 39 kg, e 0,35 gr të marihuanës e cila është konfiskuar dhe pastaj sipas mostrave të percjellura në ekspertizë që ka rezultuar të jetë marihuan si dhe nga transkriptët e bisedave që kanë zhvilluar në mëngjesin e datës 22.10.2016 të akuzuarit ndërmjet veti ku në video incizim të transkriptove në mënyrë të qartë është vërtetuar koordinimi i tyre përmes bisedave të zhvilluar për të sjellur këtë dërgesë në Kosovë, krejtë kjo më qëllim të shitjes. Duke marrë për bazë se këtu i akuzuari Gj.K dhe K.Z edhe më herët kanë qenë të dënuar nga Gjykata themelore në Gjilan, konsiderohen recidivist dhe pa mëdyshje janë marrë me këtë veprimtari kriminale. Në veprimet e tyre krijohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara në dispozitiv ashtu që i propozoj gjykatës të akuzuarit të shpallën fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit. Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ti ketë parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit në veçanti të ketë parasysh rrethanat renduese se transporti i marihuanës në sasi të mëdha me qëllim të shitjes në pikën kufitare është bërë përditshmëri.

Mbrojtësi i të akuzuarit Gj.K – av. B.Sh, fjalën përfundimtare gjykatës ia ka dorëzuar me shkrim. Si dhe ka shtuar se sa i përket cilësimit juridik nga ana e prokurorisë se në veprimet e të pandehurit Gj.K përmbushen të gjitha elementet e kryerjes së veprës penale nga neni 273 parag. 2 lidhur me nenin 281 parag. 1 nën prag. 2.9 dhe nenit 31 te KP-së, konsideron se deri sa nuk është dhënë vlera e saktë e substancave narkotike të sekuestruara dhe deri sa me asnjë dispozitë të KP-së nuk përcaktohet domethënia e fjalës sasia e madhe konsideron se neni 281 parag. 1 pika 1.9 te KP-së nuk mund të aplikohet në rastin konkretë, me nenin 120 të KP-së janë dhënë domethëniet e shprehjeve në këtë Kod dhe asnjë paragraf i atij neni nuk e përcakton se çka konsiderohet sasi e madhe duke u nisur nga ky fakt konsideron se në rastin konkretë duhet të zbatohet dispozitat e nenit 3 te KPP-së, respektivisht parimi “ In dubior pro reo”, prokuroria gjatë këtij shqyrtimi nuk e ka dëshmuar respektivisht nuk ka treguar se pse kjo sasi e sekuestruar konsiderohet si sasi e

madhe ashtu që në ekzistim të mëdyshjeve të fakteve të rëndësishme gjithsesi ajo mëdyshje duhet të interpretohet në dobi të të pandehurit, Prokuroria gjatë fjalë përfundimtare ka ndryshuar përshkrimin e veprës penale ashtu që tani në bashkëkryerje e ka futë edhe të pandehurit A.M duke pretenduar se i njëjti se bashku me dy të pandehurit tjerë, me qëllim të kryerjes së veprës penale të pretenduar janë nisur nga Gjilani për në vend kalimin kufitar në Vërmicë të Prizrenit. Nga provat e nxjerrura gjatë seancës kryesore me asnjë provë nuk është dëshmuar se i pandehuri A.M së bashku me dy të pandehurit tjerë është nisur nga Prizreni. Një ndryshim i tillë është pritur që prokuroria në fjalën e saj përfundimtare në mënyrë të argumentuar do të ofronte shpjegime për këto veprime të të pandehurit. Gjykatës i propozon që në rast se vërtetohet se në veprimet e të pandehurit Gj. janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar që me rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese e posaçërisht të ketë parasysh se i pandehuri Gj. është familjar, gjendjes jo të mirë shëndetësore, qëndrimin korrektë gjatë gjykimit. Në pjesën tjetër ka ngelur në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me shkrim.

I akuzuari Gj.K në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën e mbrojtësit të tij dhe shton se vetëm një person le të gjendet se ky i akuzuari i ka shitur ndonjë substancë narkotike.

Mbrojtësi i të akuzuarës K.Z – av. S.M, fjalën përfundimtare gjykatës ia ka dorëzuar me shkrim. Si dhe ndër të tjera ka shtuar se duke i referuar fjalës përfundimtare të prokurorit të shtetit lidhur me dispozitivin e aktakuzës ku theksohet se e akuzuari K.Z ka komunikuar me të akuzuarin A.M ne ketë drejtim konsideron se nuk ka asnjë provë, nëse bazoheni në provat materiale që janë nxjerrë gjatë shqyrtimit kryesor nga CD dhe transkripti po ashtu nuk ka asnjë provë se i akuzuari A.M të ketë lajmëruar K. me telefon, këto janë theksimet e prokurorit ne fjalën përfundimtare në dispozitivin që diktoji, këto konstatime nuk qëndrojnë, konsideron se e tërë aktakuza përkitazi me K.Z bazohet ne supozime nuk ka prova të prekshme konkrete, veprimet e saja lidhur me rastin se çka ka ndërmarrë, nuk ka mundur të bindet se e njëjta se çfarë angazhimi ka bërë rreth kësaj dërgese, nga biseda telefonike ekziston vetëm biseda me vajzën e saj S., e ajo bisedë nuk është objekt i akuzës në këtë drejtim konsideron qe ne mungesë të provave e njëjta të lirohet nga aktakuza. Në pjesën tjetër ka ngelur në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me shkrim.

E akuzuara K.Z në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të saj, dhe ka shtuar se nuk ka qenë në dijeni se çfarëdo lloji transporti, kurrë nuk është marrë me lëndë narkotike, në Kosovë ka ardhur që të punoj me biznes të bluarjes së miellit, në Shqipëri ka punuar mbi 20 vite, me këtë biznes të bluarjes së miellit.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M av. A.B, fjalën përfundimtare gjykatës ia ka parashtruar me shkrim. Në të cilën fjalë përfundimtare ndër të tjera ka theksuar se A.M ditën kritike nuk ka qenë në dijeni se këta tre thasë në brendi kanë substanca psiko trope dhe analoge të cilët janë të rrezikshme për shoqërinë, personat e pa njohur i kanë thënë se në këta tre thasë ka çorap të paketuar dhe nuk mundem ti kaloj në doganë pasi që kanë probleme me doganierin. Mirëpo pasi haset në flagrancë nga policia kufitare atëherë e kupton se në brendinë e këtyre thasëve paska marihuan, kjo shifet qartë nga video incizimi. Po ta kishte

ditur A.M se këta thasë kanë marihuan një veprim të tillë nuk do ta kishte bërë, por personat e pa njohur e kanë shfrytëzuar paaftësinë, besimin dhe ndërgjegjen e tij të cilën e kanë mashtruar duke e shfrytëzuar mendjelehtësinë dhe pa aftësinë e tij që ta bëjë një veprim të tillë. Mbrojtja në seancën gjyqësore e ka kundërshtuar me arsye ekspertizën e mjekut B.O pasi që i njëjti nuk i ka shiquar shkresat e lëndës pasi që në deklaratat që i ka dhënë në polici, prokurori, këto deklarata nuk përputhen në ekspertizën e këtyre mjekëve, në ekspertizë thuhet se lehtë nuk mund të manipulohet dhe e cekë se këtë shpërblim që ka me kryer ka me marrë pesë mijë euro. Duke kërkuar nga gjykata që mos t'ia fal besimin ekspertizës pasi që e njëjta është në kundërshtim me deklaratat e më hershme e që u vërtetua në seancë gjyqësore. Bazuar në të lartë cekurat dhe në administrimin e provave veç e veç ku u vërtetua gjendja faktike se i akuzuari A.M është zanur në flagrancë me tre thasë duke transportuar. Mbrojtja i propozon gjykatës që gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese.

I akuzuari A.M në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, dhe shton se është hera e parë që vie në Kosovë, kushtet i ka të vështira, për shkak të kushteve të vështira as familjarët nuk mund të vinë në vizitë, kërkon nga gjykata që të shqipton një dënim sa më të butë.

Gjykata duke vlerësuar provat e administruara në procedurë, në pajtim me nenin 8 dhe nenin 361 të KPP-së, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datë 22.10.2016, në periudhën kohore prej 05:40 deri me 07:50 minuta, pa autorizim kanë transportuar dhe ndërmjetësuar transportin e dërgesës - substancës psikotrope të llojit marihuan me qëllim të shitjes ose ofrimit për shitje në atë mënyrë që të akuzuarit Gj.K dhe K.Z janë nisur drejtë kufirit Kosovë – Shqipëri për të sjellur dërgesën në Kosovë prej 39 kg e 0,35 gr, substancë psikotropike të llojit marihuan, me ç “rast i akuzuari Gj.K dhe K.Z kanë pritur në territorin e Kosovës në afërsi të vend kalimit kufitar duke komunikuar dhe koordinuar dërgesën e marihuanës me të akuzuarin A.M i cili nga territori i Shqipërisë paraprakisht ka pranuar dërgesën me marihuan nga personi i cili quhet B.. (A.), e pastaj ka kaluar në këmbë në territorin e Kosovës duke shfrytëzuar bregun e liqenit të fshatit Vërmicë, ashtu që bartë në shpinë tri thasë në të cilën janë gjetur 60 paketime të mbështjellura me substancë psikotropike të llojit marihuan dhe një najlon me ngjyrë të zezë po ashtu të mbushur me substancë psikotropike marihuan me peshë totale prej 39 kg, e 0,35 gr, i cili po sa të vërehet nga ana e zyrtarëve policor të cilët kanë qenë në pikë vëzhgim afër bregut të liqenit i akuzuari A.. largohet me vrap duke i hudhur thasët dhe lajmëron me telefon të akuzuarin Gj.K dhe K.Z se është i rrethuar dhe ndaluar nga policia kufitare.

Gjendjen e këtyllë faktike gjykata e ka vërtetuar nga raporti i ekspertizës të agjensionit për forenzik me nr. AKF-2016-3191/2016-2852 te dt.22.12.2016, lista e dëshmive të njësitit të forenzikës e dt. 22.10.2016, lista e dëshmive një CD me video incizim nga vendi i ngjarjes të datës 22.10.2016, foto albumi i njësitit të forenzikës e dt. 22.10.2016, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga i akuzuari A.M, dy CD me përgjime ndërmjet të akuzuarve A.M, Gj.K dhe K.Z, bëheet leximi i transkriptëve të përgjimeve të datës 22.10.2016, raporti i ekspertizës të institutit të psikiatrisë forenzike dhënë për gjendjen e shëndetit mendor të akuzuarit A.M me nr. 134/2 të datës 14.04.2017, dëshmia e ekspertit Dr. B.O, dhe deponimi i të akuzuarve.

Nga raporti i ekspertizës të Agjencionit për forenzik me nr. AKF-2016-3191/2016-2852 te dt.22.12.2016, së bashku me mostrat e marihuanës padyshim që është vërtetuar se sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike mostrat e marrura përmbajnë Kanabis (marihuanë) dhe përmbajnë Tetrahidrokanabinol (THC). Kanabisi (marihuana) është bimë narkotike e kategorizuar në tabelën I të ligjit për barna narkotike dhe substanca psikotrope, substanca të ndaluar me ligj. Të cilës provë gjykata ia fali besimin e plotë.

Nga lista e dëshmime të njësitit të forenzikës e dt. 22.10.2016, është vërtetuar se nga njësitet përkatëse të antidrogës është sekuestruar substanca narkotike e cila substancë pas analizës ka rezultuar të jetë substancë e ndaluar me ligj. Nga raporti i vendit të ngjarjes del se nga policet e vijës së gjelbër në pikën kufitare në Vërmicë është arrestuar i akuzuari A.M duke u futur në territorin e R së Kosovës afër bregut të liqenit me një ngarkesë prej 3 thasëve, në të cilët thasë më pas ka rezultuar të jetë substanca narkotike në peshë të përgjithshme prej 39 kg 035 gr, të mbështjellura në 60 (gjashtëdhjetë) paketime me foli najloni ngjyrë të bardhë dhe 1 (një) thes najloni ngjyrë të zezë. E gjithë kjo ngjarje është regjistruar përmes audio video inqizimeve dhe fotografive të cilët janë bërë nga ekspertet e krim teknikës. Ky përshkrim përkon me të gjitha provat tjera materiale si dhe dëshminë e të akuzuarit A.M, i cili në tërësi e pranon se ditën kritike nga zyrtarët policor është hasur duke e transportuar substancën narkotike e cila më pas është sekuestruar dhe është dërguar për ekzaminim e cila ka rezultuar substancë narkotike e llojit marihuanë, substancë e ndaluar me ligj. Të cilës provë gjykata ia fali besimin e plotë.

Nga lista e dëshmime një CD me video incizim nga vendi i ngjarjes të datës 22.10.2016, është vërtetuar nga ky video incizim se i akuzuari A.M pas arrestimit në stacionin policor pranë pikës kufitare në Vërmicë, pranon në tërësi se thasët që i ka poseduar ditën kritike kanë substancë narkotike. Destinacioni i substancës narkotike ka qenë Prishtina dhe se ky vetëm e ka transportuar. Të cilës provë gjykata ia fali besimin e plotë.

Nga foto albumi i njësitit të forenzikës e dt. 22.10.2016, është vërtetuar se substanca narkotike është sekuestruar ditën kritike dhe e njëjta substancë është fotografuar, ky fakt shihet nga fotografit se si ka qenë të mbështjellura. Nga këto fotografi shihen edhe mostrat e substancës të cilat janë marr dhe janë dërguar për ekzaminim. Substanca narkotike është peshuar në momentin e sekuestrimit. Këto fotografi përkojnë me të gjitha provat materiale e sidomos me video incizimin ku shihet i akuzuari A.M pranë substancës narkotike duke theksuar se si ka ardhur deri tek kjo substancë dhe destinacioni i substancës. Të cilës provë gjykata ia fali besimin e plotë.

Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga i akuzuari A.M, është vërtetuar se ditën kritike janë sekuestruar 60 (gjashtëdhjetë) paketime substancë narkotike e llojit marihuanë të mbështjellura me foli najloni dhe një thes najloni ngjyrë të zezë të mbushur me substancë narkotike, në peshë të përgjithshme prej 39 kg 035 gr, substancë narkotike e llojit mariahunë, e vërtetuar me anë të ekzaminimit laboratorik ka rezultuar si substancë e rrezikshme dhe e ndaluar me ligj. Kjo provë përkon me të gjitha provat tjera materiale. Të cilës provë gjykata ia fali besimin e plotë.

Nga shikimi - dëgjimi dy CD me përgjime ndërmjet të akuzuarve A.M, Gj.K dhe K.Z, është vërtetuar se bisedat që janë bërë në mes të akuzuarit Gj.K me personin e quajtur B..

(A..) i cili është duke e pritur personin që do ta transporton substancën narkotike e gjithë biseda bëhet se është vonuar personi që do ta bëjë transportin e substancës narkotike. Pastaj biseda vazhdon në mes të akuzuarit Gj.K dhe A.M. A.M e njofton të akuzuarin Gj.. se nga personi me emrin A.. e morri (bëhet fjalë për substancën narkotike) dhe se dy thasët i ka futur dhe është duke e futur edhe thesin e fundit, e njofton për vendin ku ndodhet afër një shpelle (antena Gorrozhup), gjatë bisedës i akuzuari A.. e njofton të akuzuarin Gj.. se është rrethuar nga policia, atëherë i akuzuari Gj.. e udhëzon që ti lënë thasët dhe të largohet me vrap. Pas kësaj biseda vazhdon në mes të akuzuarit Gj.. dhe personin e quajtur A., të cilin e njofton që të largohet, duke e njoftuar se i akuzuari A.. është rrethuar nga policia e Kosovës. Pas gjithë kësaj e akuzuara K.Z e cila gjatë gjithë kësaj kohe ishte së bashku me të akuzuarin Gj.K në pritje të dërgesës, përmes telefonit të Gj.K e telefonon vajzën e saj me emrin S.. e cila gjendet në hotel në ... dhe nga ajo kërkon që ti hekë të gjitha qeset e zeza, nga komodina e Gj.. ti hekë do pluna, dëgjohet zëri i Gj.K duke i thënë se do ta dërgojë njërin dhe do i merr si dhe ja tregon edhe kodin “...” që ta merr numrin e personit të quajtur M... Pas kësaj e akuzuara K.Z e pyet vajzën e saj S.. se a i ka hequr të gjitha qeset, qesen që ka qenë te komodina si dhe peshoren dhe e njofton se vjen personi me emrin M.J dhe i merr të gjitha, pas bisedës që bënë me këtë person i telefonon vajzës që tia dorëzon tek shkallët e hotelit. Gjithë bisedat që janë bërë janë bërë përmes numrave të telefonit 049-479-108, ..., ... dhe Nga kjo CD është vërtetuar padyshim se si ka lëvizur numri i telefonit 049-479-108 të cilin e ka poseduar i akuzuari Gj.K ditën kritike sipas antenave dhe atë nga ... në Ferizaj, Shtimje, Reçak, Bllacë, Suharek, Mushtishtë, Vellezh dhe Gorrozhup në vendin ku është arrestuar i akuzuari A.M. I akuzuari A.M ditën kritike ka poseduar numrin e telefonit ... i cili numër dhe telefon është sekuestruar nga policia e Kosovës. E akuzuara K.Z ditën kritike e ka përdorur numrin e telefonit të Gj.K dhe se numrin e vetë ... ia ka lënë në posedim të vajzës së saj S... Personi i quajtur “A..” (B..) ka përdorur numrin e telefonit ... operator i R së Shqipërisë si dhe ky person gjatë gjithë kohës ka qëndruar në territorin e R së Shqipërisë. Kjo provë padyshim që përkon me të gjitha provat tjera materiale dhe e vërteton në tërësi gjendjen faktike si në aktakuzë, veprimet dhe rolin e të akuzuarve në kryerjen e kësaj veprë penale. Të cilës provë gjykata ia fali besimin e plotë.

Nga leximi i transkriptëve të përgjimeve të datës 22.10.2016, është vërtetuar në tërësi bisedat telefonike në mes të akuzuarve lidhur me substancën narkotike. Këto transkripte janë në përputhje me dëgjimin e CD-ve dhe në mënyrë të saktë është bërë deshifrimi i bisedave nga CD-ët në transkripte pa kurrfarë ndryshimi. Këto transkripte vërtetojnë saktë se çka kanë biseduar të akuzuarit ditën kritike lidhur me substancën narkotike. Padyshim që këto prova janë në harmoni me CD-ën dhe me provat tjera.

Nga raporti i ekspertizës të institutit të psikiatrisë forenzike dhënë për gjendjen e shëndetit mendor të akuzuarit A.M me nr. 134/2 të datës 14.04.2017, është vërtetuar se te i akuzuari A.M nuk konstatohet sëmundje e përkohshme apo e përhershme mendore. Te i njëjti nuk konstatohet ngecje në zhvillimin psikomotor. I njëjti nuk është i manipulueshëm dhe nuk manipulohet lehtë. Në momentin e kryerjes së veprës penale aftësia e tij mendore e të kuptuarit dhe e kontrollës së veprimeve të veta për veprën për të cilën ngarkohet ka qenë e ruajtur. Kjo provë është në harmoni me dëshminë e ekspertit Dr. B.O dhe me provat tjera. Të cilës provë gjykata ia fali besimin e plotë.

Dr. B.O në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor lidhur me gjendjen e shëndetit mendor të të akuzuarit A.M, ka theksuar se është nënshkruar i ekspertizës së dhënë me shkrim. Ekspertiza bazohet në një raport i mjekut të dhënë nga qendra e paraburgimit dhe në informatat që i kanë marr nga i akuzuari dhe bashkëshortja e tij L.M

dhe se kanë qenë të mjaftueshme për të ardhur tek konkludimi. Gjatë ekzaminimit klienti – i akuzuari ka pasur tendenca manipulative ndaj tyre dhe se kjo ka qenë arsyeja pse është dhënë konstatimi se ai nuk është lehtë i manipulueshëm, në asnjë moment i akuzuari nuk ka dashur të bisedoj në lidhje me detajet e arritjes së tij deri në momentin kur është paraburgosur, gjithmonë këto informata kanë qenë të selektuara si që është përshkruar dhe në statusin psikik, personat të cilët janë lehtë të manipulueshëm nuk e kanë këtë veti. Së fundmi eksperti qëndron në tërësi pranë raportit me shkrim.

Gjykata duke analizuar dëshminë e Dr. B.O, nga kjo dëshmi është vërtetuar në tërësi gjendja shëndetit mendor për të akuzuarin A.M dhe se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndonjë çrregullim për të akuzuarin dhe se ditën kritike i akuzuari ka qenë në dijeni se është duke transportuar substancë narkotike ky fakt vërtetohet edhe nga shikimi i CD-së ku i akuzuari e përshkruan ngjarjen pranë stacionit policor ku thekson “*se kjo është substancë narkotike e llojit hashash*” si dhe tregon edhe peshën e saj. Kjo dëshmi e ekspertit përkon me raportin e dhënë me shkrim dhe me provat tjera. Të cilës dëshmi gjykata ia fali besimin e plotë.

I akuzuari Gj.K në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se ditën kritike ka qenë në ... dhe se nuk ka udhëtuar askund pasi që nuk ka pasur makinë. Gjatë kësaj periudhe ka përdorur numër të telefonit të R së Shqipërisë dhe numër të Kosovës të operatorit... dhe se nuk i kujtohet numri. Ditën kritike është takuar me të akuzuarën K.Z në ... në mëngjes kanë pirë kafe dhe pas pirjes së kafes i akuzuari ka lëvizur nëpër ... ndërsa e akuzuara K.Z ka qëndruar në shtëpi. I akuzuari ka punuar në një mulli bluarje në Viti si punëtor dhe se ka banuar në Motel në ... dhe se e njëjta ka qenë si shtëpi. Aty ka banuar edhe e akuzuara K.Z së bashku me bashkëshortin, vjehrrën dhe sipas rasteve i kanë ardhur edhe fëmijët. S.. është vajza e K... K.. së bashku me të akuzuarin dhe burrin e saj ka punuar në Mulli në Ndaj të akuzuarit është zhvilluar një procedurë gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në ... për veprën penale transport të barit – Marihuan. Të akuzuarin A.M e njeh rreth 6-7 vite pasi që kanë punuar në mulli në ... të R. së Shqipërisë, të njëjtin e kanë ftuar në ... për të punuar në mulli dhe se A.. ka qenë tek ta. Me dt. 22.10.2016 rreth orës 05:40 minuta nuk i kujtohet që te këtë kontaktuar me A... Personin me emrin B.. nuk e njeh. Personin me emrin M.. e njeh dhe se me te ka nejtur dy herë. Nuk e din domethënien e kodit 1967. Sa i përket zërit të dëgjuar në CD ka theksuar se i përngjan zërit të tij por ky nuk ka biseduar me A...

E akuzuara K.Z në mbrojtjen e saj dhënë në shqyrtimin gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se A.M e njeh që 15 vite e ka pasur punëtor në fabrikën e miellit në Po ashtu e njeh edhe Gj.K i cili ka qenë menaxher në fabrikën e miellit në ..., personin me emrin A.. nuk e njeh. Në Kosovë ka ardhur dhe ka hapur fabrikën e miellit në ... sepse në Shqipëri është bërë konkurrencë e madhe. Në ... ka banuar në banës me qira së bashku me bashkëshortin dhe të akuzuarin Gj., herë pas here ka ardhur në vizitë edhe vajza S... Fabrika në ... ka qenë e pronarit R.Gj. E di që Gj.i është arrestuar në mars me që atë ditë e kanë kapur me një sasi të madhe të ashashit – marihuanës, kanë qenë policia në shtëpi kanë bërë kontrollimin dhe se nuk kanë gjetur asgjë por në hotelin në ... kanë gjetur një sasi të marihuanës prej 12 kg. Gj.i nuk ka pasur makinë, e ka shfrytëzuar makinën tonë dhe diku në 2016 në korrik kjo makinë është përfshihej në një aksident dhe e kanë shitur për hekur. Me dt. 22.10.2016 nuk ka qenë se bashku me Gj.. dhe se nuk ka pasur numër të kompanisë Me vajzën ka biseduar me dt. 22.10.2016, të cilës i ka thënë që ti merre gjanat të sirtari do pluhura qese, çantën që ti hekë dhe ti dërgon tek makina, gjatë bisedës e akuzuara ka qenë duke shkuar

në Viti dhe se nuk i kujtohet se a ka qenë se bashku me Gj., nuk i kujtohet ti ketë thënë S.. që ta thirre personin me emrin M.. me kodin Peshorja ka qenë e lokalit dhe me të kanë matur gjësede ushqimore. Për arrestimin e A.M ka kuptuar më vonë kur e ka përmendi prokurori në Në ... ka qenë e dënuar pasi që gabimisht është takuar me Gj.. dhe se Gj.. ka qenë nën vëzhgim të policisë ku është zënë me 12 kg marihuan.

I akuzuari A.M në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se një javë para se ta kaloj kufirin nga Shqipëria për në Kosovë me tre thasë në shpinë për të cilët kam menduar se janë veshmbathje është takuar me një person nga Shqipëria në Tiran gjersa ishte duke punuar në lloç. Personi me makinë e ka përcjellur deri në kufi një javë pasi që kanë biseduar dhe i ka thënë se janë veshmbathje ato ishin të vendosura në dy thasë, i beson atij nuk e ka hapur me shikuar përmbajtjen dhe se si shpërblim do ti ketë 100 euro, nuk i ka treguar se cili person ka mi pranuar ato thasë dhe se nuk e dinë emrin e personit që do ti pranon dhe se nuk është interesuar qëllimin e ka pasur vetëm të merre 100 euro. Personi në fjalë e ka sejtur deri në kufi Shqipëri-Kosovë aty kanë ndaluar ka hyrë ka mali për gjatë liqenit ashtu që policia kufitare e ka ndaluar dhe ka konfiskuar thasët. Pas arrestimit ka kuptuar se në thasë ka patur marihuan dhe nuk ka pasur veshë mbathje. Këto thasë ka pasur që ti le tek restoranti i parë në Po ta kishte ditur se thasët përmbajnë substancë narkotike nuk do ta bënte një veprim të tillë. Deklaron se të akuzuarin Gj.K nuk e njeh ndërsa të akuzuarën K.Z e njeh rreth 5 vite, dhe se në Kosovë asnjëherë nuk është takuar me të akuzuarën K... Te K.Z kam punuar në fabrikën e miellit në ... dhe se e njëjta ka qenë punëtore e kësaj fabrike. Ditën kritike nuk ka biseduar me të akuzuarën K.Z përmes telefonit, ndërsa në video incizim mund të ketë qenë zëri i tij. Gjatë arrestimit ka pasur me veti numër të telefonit të R. së Kosovës.

Gjykata, duke i analizuar mbrojtjet e të akuzuarve, këtyre mbrojtjeve nuk ia fali besimin pasi që konsideron se këto mbrojtje janë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe në kundërshtim me provat e administruara, janë drejtuar me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale. Gjatë mbrojtjes i akuzuari Gj.K ka theksuar se e njeh të akuzuarin A.M ndërsa i akuzuari A.M ka mohuar që njihet me të akuzuarin Gj.K. Nga provat e administruara pa dyshim është vërtetuar fakti se ditën kritike i akuzuari Gj.K ka poseduar numrin e telefonit ... dhe A.M numrin e telefonit ... të cilët kanë biseduar nga ora 05:40 min deri në momentin e arrestimit të akuzuarit A.M. I akuzuari A.M e ka njoftuar për çdo detaj lidhur me këtë dërgesë të substancës narkotike dhe se i akuzuari Gj.K i ka dhënë instruksione se si të veprojnë. Padyshim që gjatë gjithë kohës me të akuzuarin Gj.K ka qenë prezent edhe e akuzuara K.Z e ky fakt është vërtetuar se pas marrjes së informatës nga A.M se është rrethuar nga oficerët policor ajo me numrin e telefonit të cilin e ka poseduar i akuzuari Gj.K ... ka telefonuar vajzën e saj në numrin e telefonit ... nga e cila ka kërkuar që gjësendet që gjenden tek komodina dhe qeset e zeza ti largojë nga shtëpia – Moteli ku kanë banuar dhe t'ia dorëzon personit të quajtur "M..". Ky fakt vërtetohet se nga antena e telefonisë ... rezulton se numri i telefonit i cili është përdorur nga i akuzuari Gj.K ... ka qenë në regjionin e Gorozhubit që i bie në kufi me Shqipërinë po ashtu edhe numri i të akuzuarit A.M 049-479-458 nga antena rezulton se ka qenë në regjionin e Gorozhubit. Me këto prova bie poshtë mbrojtja e të akuzuarve Gj.K dhe K.Z se ditën kritike kanë qenë në Numri i telefonit ... të cilin e ka poseduar Gj.K ditën kritike në bazë të antenave ka lëvizur nga ..., Ferzaj, Shtimje, Reçak, Bllacë, Mushtishtë, Velezh, Prizren dhe Gorozhub vendi kufitar mes Kosovës dhe Shqipërisë, ku edhe është arrestuar i akuzuari A.M. Nga provat e administruara dhe nga bisedat telefonike është vërtetuar fakti se i akuzuari A.M ka qenë në

dijeni se ditën kritike thasët kanë qenë të mbushur me substancë narkotike e gjithë kjo bazuar në faktin se këta tre të akuzuar janë njohur mirë njëri me tjetrin kanë punuar bashkë në një mulli në ... të Shqipërisë dhe se ditën kritike i akuzuari A.M substancën narkotike e pranon nga personi i quajtur A.. dhe pas pranimi të kësaj substance narkotike niset në drejtim të Kosovës ku ishin duke e pritur të akuzuarit Gj.K dhe K.Z në pikën kufitare të Vërmicës.

Gjykata nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, duke e analizuar secilën provë veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku në tërësi ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve Gj.K, K.Z dhe A.M formohen të gjitha elementet e veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 parag. 2 lidhur me nenin 281 parag. 1 nën parag. 1.9 dhe neni 31 të KP-së, në atë mënyrë që të akuzuarit me dashje dhe me vetëdije të plotë të vetëdijshëm për veprimet e veta kanë kryer veprën penale për të cilën ngarkohen, andaj gjykata të njëjtit i ka shpallur fajtor dhe iu ka shqiptuar dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penale juridike.

Gjykata ka refuzuar propozimin e mbrojtësit të akuzuarit Gj.K av. B.Sh që të kërkohet pronësia e numrit të telefonit të cilin e ka poseduar i akuzuari Gj.K, për gjykatën nuk është kontestues fakti se i akuzuari Gj.K ka qenë posedues i këtij numri e që ky fakt është vërtetuar nga biseda që ka pasur K.Z përmes këtij numri me vajzën e saj S., nga sekuestrimi i telefonit të akuzuarit A.M i cili ditën kritike ka biseduar me të akuzuarin Gj.K me numrin e telefonit ... dhe nga urdhëresa për masa të fshehta të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i krimeve të Rënda PNKR.nr.188/15 e datës 28.09.2016 del se numri 049-479-108 është përdorur nga i akuzuari Gj.K dhe ky numër është përgjuar. Të gjitha numrat e lartcekur të cilët i kanë përdorur të akuzuarit kanë qenë nën masën e përgjimit.

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve vlerësoj të gjitha rrethanat si ato rënduese dhe ato lehtësuese në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethanë rënduese për të akuzuarin Gj.K ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, sasinë e substancës narkotike të konfiskuar, edhe më parë ka qenë i dënuar për kësi lloj vepra penale dhe është në vuajtje të dënimit (nga Gjykata Themelore në Gjilan), rrezikshmëria e këtyre veprave penale për shëndetin e qytetarëve. Si rrethanë lehtësuese është marrë gjendja ekonomike e tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar.

Si rrethanë rënduese për të akuzuarin K.Z ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, sasinë e substancës narkotike të konfiskuar, edhe më parë ka qenë e dënuar për kësi lloj vepra penale (nga Gjykata Themelore në Gjilan), rrezikshmëria e këtyre veprave penale për shëndetin e qytetarëve. Si rrethanë lehtësuese është marrë gjendja ekonomike e saj, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e saj, është familjare.

Si rrethanë rënduese për të akuzuarin A.M ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, sasinë e substancës narkotike të konfiskuar, rrezikshmëria

e këtyre veprave penale për shëndetin e qytetarëve. Si rrethanë lehtësuese është marrë gjendja ekonomike e tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë.

Prandaj, gjykata të akuzuarve iu shqiptoi dënimin me burg dhe dënimin me gjobë sepse konsideron se me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tyre penale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Në bazë të gjithë të cekurave më lartë, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve formohen elementet e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga të lartë cekurat u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i krimeve të Rënda
PKR.nr.61/17 me datë 23.01.2018

Procesmbajtësja
Florije Kolukaj

Kryetari i trupit gjykues,
Artan Sejrani

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.